

**PROGRAMI “MBI OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET PËR ZBATIM NË KLSH
NË 100 DITË, NGA 3 JANARI 2012 DERI MË 15 PRILL 2012”**

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
I.	Vizion koherent për KLSH-në, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimi rigoroz i standardeve ndërkombëtare të kontrollit të miratuar nga INTOSAI.	<p>1. Përgatitja e raporteve përkatëse për veprimtarinë e vitit 2011 të kryer nga secili departament, drejtori dhe në nivel institucioni, si dhe kryerja e analizave me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve. Analizat të jenë të hapura dhe në praninë e mediave e të OJF-ve.</p> <p>2. Përgatitja dhe dërgimi në Kuvend i raportit “Mbi veprimtarinë e KLSH të vitit 2011”</p> <p>3. Marrja e komenteve dhe sugjerimeve përfundimtare nga SIGMA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Komisionit të BE, për rishikimin dhe bërjen e amendimeve në Ligjin Organik të KLSH.</p> <p>4. Paraqitja e ndryshimeve në ligjin organik të KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.</p> <p>5. Rishikimi dhe hartimi i rregullores së re të brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH, duke e harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, amendimet e pritshme të KLSH, si dhe manualët e auditimit financiar e të performancës. Në hyrje të parashtrohen sfidat që do të arrijë institucioni, më pas organizimi dhe përcaktimi i strukturave duke vijuar me radhë kapitujt e tjerë, përfshirë anekse të veçantë për procedurën e kontrollit.</p>	<p>Deri 20 janar 2012</p> <p>Deri 29 shkurt 2012</p> <p>Deri 10 mars 2012</p> <p>Deri 10 prill 2012</p> <p>Shkurt 2012</p>

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
		<p>Një nen i veçantë të jetë për pranimin e letrave nga populli, shqyrtimin e tyre dhe dhënien e përgjigjeve letërshkruesve.</p> <p>Shënim: Ndërmjet materialeve që do të shfrytëzohen për përvojë, vend të veçantë të zerë modeli (materiali) i ECA për rregulloren.</p> <p>6. Bërja e ndryshimeve në Kodin Etik të KLSH, në funksion të etikës institucionale, për të treguar respekt dhe vlerësim për kontributin e dhënë nga Kryetarët e KLSH në vite, vënia në dispozicion të kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për Kryetar të KLSH, të një pakete të plotë informative me dokumentet lidhur me organizimin dhe funksionimin e KLSH, politikat, strategjitë etj.</p>	Deri 5 janar 2012
II.	Thellimi i realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike.	<p>1. Rigjallërim dhe intensifikim i komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar më 6 maj 2009, ndërmjet Prokurorisë Përgjithshme, MB, MF, SHISH, ILKDP e KLSH.</p> <p>Për këtë, të përgatitet një material nga ana e jonë, ku krahas punës së bërë, t'u kërkohet partnerëve të sipërcituar, që përpara çdo takimi, një grup pune i përbashkët të përgatisë dhe shpërndajë një raport përmbledhës pune.</p>	Shkurt 2012
		<p>2. Rishikimi me qëllim bërjen efektive të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1257 dhe nr. 522, datë 6.5.2005, të nënshkruar nga ish Kryetari i KLSH dhe ish Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së</p>	Shkurt 2012

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
		<p>Shqipërisë.</p> <p>3. Aktivizimi i një adrese e-mail dhe një numër telefoni falas, për të lehtësuar komunikimin e qytetarëve me KLSH. Për këtë, të bëhet njoftim për të gjitha mediat.</p>	Shkurt 2012
III.	<p>Përmirësimi i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen në auditimin e performancës, krahas rritjes së eficiencës së auditimit financiar.</p> <p>Përmirësimi si nga ana e përmbajtjes dhe e pamjes vizuale të materialeve të kontrollit, sidomos të projektraportit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit.</p>	<p>1. Përditësimi i manualit të auditimit të performancës. Përkthimi i udhëzuesit të auditimit të performancës, parimet kryesore (ISSAI 3100).</p> <p>2. Hartimi dhe konsultimi i formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe krijimi i lehtësive për përdorimin për zbatim të tyre.</p> <p>3. Përmirësimi i paraqitjes dhe i përmbajtjes së materialeve të kontrollit, duke filluar nga shkresa për fillimin e kontrollit dhe deri te Projektraporti i Kontrollit dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit. Për këtë, të rishikohet në tërësi përmbajtja e urdhrin të brendshëm të ish Kryetarit të KLSH me nr. 20, date 26.5.2005 “Për evidentimin, paraqitjen dhe raportimin e rezultateve të kontrollit, si dhe hartimin e dokumentacionit bazë të kontrollit”, i ndryshuar, duke e zëvendësuar atë me materiale të përmirësuar dhe të miratuar me një urdhër të ri.</p> <p>4. Në çdo program kontrollit, të shtohet një pikë e veçantë “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të</p>	<p>Mars 2012</p> <p>Prill 2012</p> <p>Deri 15 mars 2012</p> <p>Janar 2012</p>

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
		<p>menaxhimit financiar dhe kontrollit". Sa më sipër, të hartohen drejtimet e kontrollit me çështjet dhe nënçështjet objekt kontrolli.</p> <p>5. Për pranimin, shqyrtimin dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura në letrat e dërguar nga shtetasit shqiptarë, të hartohet një udhëzues i veçantë për procedurën që duhet të ndiqet për ndjekjen dhe zgjidhjen e tyre. Për hartimin e manualit të shfrytëzohet përvoja e institucioneve të tjera, si KM, Avokati i Popullit etj.</p>	Shkurt 2012
IV.	Shqyrtimi dhe përmirësimi i organigramës së KLSH, për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës për përmirësimin cilësor të veprimtarisë kontrolluese të institucionit.	<p>1. Në Departamentin e Kontrollit të BQ&ALP&KF&AB të krijohet "Sektori i Kontrollit të Buxhetit Qendror". Për këtë, të hartohen dhe paraqiten për miratim të drejtat dhe detyrat e këtij sektori, ku ndër to të përfshihet detyrimi që punonjësit e këtij Sektori, për nevoja pune mund të marrin pjesë në kontrolle të natyrave të tjera.</p>	Deri 10 shkurt 2012
		<p>2. Krahas fuqizimit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë me juristë me integritet dhe të përgatitur profesionalisht, çdo Departament Kontrolli të plotësohet me nga 2 juristë të përgatitur profesionalisht dhe me përvojë pune.</p>	Struktura e re e KLSH, deri 15 prill 2012
V.	Realizimi i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë apo të	<p>1. Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit</p>	Shkurt 2012

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
	ngjashme, institucione të cilët luajnë rol dhe kanë përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit.	dhe Kontrollit të Pasurive. 2. Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës.	Shkurt 2012
VI.	Intensifikimi i komunikimit, konsultimeve dhe ndërveprim me Qeverinë dhe me partnerë të tjerë institucionalë.	1. Përgatitja dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrit dhe Drejtorin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në KM, lidhur me koordinimin e punëve dhe shkëmbimin e përvojave në përpjekjet për parandalimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit. 2. Përgatitja dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik, me synim rritjen e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të punës audituese dhe inspektuese.	Shkurt 2012 Shkurt 2012
		3. Krahas dërgimit në Departamentin e Administratës Publike të të dhënave për nëpunësit publikë të përgjegjësuar për shkelje nga më të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës, në Raportet Përfundimtarë të KLSH të vitit 2011 (libri gri), të kërkohet lidhja e një marrëveshjeje bashkëpunimi në këtë fushë me DAP pranë Ministrit të Brendshme.	Shkurt 2012

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
VII.	Programimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë.	1. Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik.	Shkurt 2012
		2. Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.	Shkurt 2012
VIII.	Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare si INTOSAI dhe EUROSAI, me organizma të BE si Gjykata e Auditorëve dhe SIGMA, me institucionet homologe të kontrollit të vendeve të BE-së, vendeve të rajonit dhe me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.	1. Shqyrtimi i përditshëm i faqes së INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe përgatitja e dërgimi i materialeve të ndryshme për botim.	Përditë
		2. Organizimi i takimit me përfaqësuesin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe përgatitja e draft-marrëveshjes së përbashkët të bashkëpunimit me ZAP Kosovë.	Deri 13 shkurt 2012
		3. Parapërgatitje për krijimin e kushteve për nënshkrimin e marrëveshjeve të përbashkëta ndërmjet KLSH me SAI-in e Maqedonisë dhe Malin e Zi, me synim shkëmbimin e përvojave të përparura dhe organizimin e kontrolleve të përbashkëta apo paralele.	Mars 2012

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
		4. Parapërgatitje për organizimin e një takimi të përbashkët në një periudhë të përshtatshme, ndërmjet KLSH me SAI të Kroaci, Greqi, Rumani, Bullgari, Slloveni, Serbi, Mali i Zi, Maqedoni dhe Kosovë, nën monitorimin e Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe SIGMA-s, për të diskutuar dhe vendosur për çështje me interes të përbashkët rajonal në fushën e auditimit, Për këtë nismë, të informohen dhe ambasadat tona në shtetet e sipërcituar.	Deri 15 prill 2012
		5. Dorëzimi i kërkesës drejtuar SIGMA për përfundimin e asistencës teknike nëpërmjet një projekti binjakëzimi, sa më parë të jetë e mundur, me synim ngritjen e kapaciteteve në fushën e auditimit të performancës, çertifikimit të pasqyrave financiare dhe të teknologjisë së informacionit.	Shkurt 2012
		6. Rigjallërimi i marrëdhënieve me Përfaqësinë e Bankës Botërore në Tiranë.	Në vijimësi
IX.	Ngritja dhe trajnimi i kapaciteteve të nevojshme, lidhur me zbulimin dhe parandalimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit.	1. Vendosja e marrëdhënieve sistematike të bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të cilat të përcaktohen në një marrëveshje bashkëpunimi të përbashkët.	Brenda muajit mars 2012
X.	Përmirësimi i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe organizmat jo-fitimprurëse të	1. Tryezë e përbashkët me organizatat jo-fitimprurëse me prezencën e mediave për parashtrimin e hapësirave të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet KLSH dhe OJF të cilat veprojnë në fushën e	Brenda muajit shkurt 2012

Nr.	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET PËR ZBATIM	AFATI I ZBATIMIT
	interesuara për bashkëpunim.	monitorimit të financave, përgjegjshmërisë publike e problemet e korrupsionit.	
XI.	Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë	1. Dorëzimi i kërkesës së Kryetarit të KLSH në Kuvendin e Shqipërisë për lënien e imunitetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.	Janar 2012
		2. Në zbatim të nenit 3 të ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, dërgimi i kërkesës së KLSH në Kuvend për ushtrimin e një kontrolli mbi llogaritë vjetore të institucionit, nga një organizëm i pavarur i caktuar nga Kuvendi.	Janar 2012
XII.	Për vlerësimin e aftësive profesionale	1. Kryerja e testimit për vlerësimin e aftësive profesionale të kryekontrollorëve dhe të kontrollorëve të lartë.	Mars 2012
XIII.	Të ndryshme	1. Fillimi i punës për hulumtimin dhe përgatitjen e historikut të KLSH dhe marrja e masave për ngritjen e minipavioneve për vendosjen e materialeve historike në ambientet e KLSH.	Mars 2012 dhe në vijimësi